



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 9

Datë 27.07.2026 ora 10 : 00 ⁰⁰

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.3041. Prot datë 22.07.2026, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.8, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 18.06.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për ngritjen e komisionit të strehimit”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “.
- 9- Miratim i projekt- vendimit, “Për miratimin e programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë”.
- 10- Miratim i projekt - vendimit, “Për shtimin e punonjësve sezonal plazhi (me kontratë) për periudhën Gusht-Shtator 2026”.
- 11- Miratim i projekt - vendimit,” Për përlllogaritjen e nivelit të pagave për Bashkinë Rrogozhinë sipas vendimit Nr.103, datë 11.02.2026”.
- 12- Raport nga administratorët e Njësive mbi punën e bërë përgjatë periudhës Janar-Maj 2026.
- 13- Raport mbi punën e bërë nga drejtoria juridike pranë bashkisë Rrogozhinë.



- 14- Njohje me shkresën “Kthim përgjigje”, drejtuar kryetares së grupit të djathtë znj. Silvana Aliu nga drejtoria e Politikave Urbane.
- 15- Shqyrtim i kërkesës për informacion dhe ndërhyrje institucionale të anëtarit të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.
- Njohje me shkresat “Kthim përgjigje” drejtuar Këshilltarit z. Mitat Daja nga administrata e bashkisë si më poshtë :
 - *Kthim përgjigje drejtuar këshilltarit z. Mitat Daja në cilësinë e kryetarit të komisionit të përkohshëm për verifikimin e procesit të rindërtimit, shkresa me Nr.628/2.Prot datë 11.06.2026.*
 - *Kthim përgjigje nga drejtoria e shërbimeve mbështetëse shkresa me Nr.1901/4.Prot datë 17.06.2026.*
 - *Kthim përgjigje nga drejtoria e bujqësisë, shkresa me Nr.1901/2.Prot datë 16.06.2026.*
 - *Kthim përgjigje nga drejtoria e financës shkresa me Nr.628/3.Prot datë 17.06.2026*
 - *Kthim përgjigje nga drejtoria e financës shkresa me Nr.1901/3.Prot datë 17.06.2026.*
- 16- Informacion mbi evidentimin e problematikave në Institucionet Arsimore dhe marrjen e masave për rregullimin e tyre për të pasur kushte sa më optimale për vitin e ri shkollor 2026-2027.
- 17- Shqyrtim i materialit, “Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave për 6 - mujorin e parë të vitit 2026” nga Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik.
- 18- Shqyrtim i materialit “ Kthim Përgjigje ” të ardhur nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës, “Mbi treguesit kryesorë ekonomikë të Njesisë Operacionale Rrogozhinë”.
- 19- Shqyrtim i shkresave të ardhura nga Drejtoria e Financës :
 - *Kërkesë për shtyrje afati për paraqitjen e analizës mbi realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë për 6-mujorin e vitit 2026.*
 - *Mbi mosmiratimin e tavaneve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA 2027-2029).*
 - *Shkresa “Kthim përgjigje” me Nr.2660/1.Prot drejtuar Ministrisë së Financave dhe për dijeni Këshillit Bashkiak.*
- 20- Të ndryshme.
 - *Kërkesë për ndihmë financiare nga z. V. Skuqi banor i Njesisë Administrative Gosë.*
 - Të tjera.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Shpati Kolgega, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Sokol Gosa, Besnike Coraj, Dhurata Meka, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.



Mungojnë :

Mitat Daja, Saimir Cani, Merilin Saraçi, Lije Dedej, Renato Kalemi, Alime Hoxha Lorena Baku.

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Astrit Mertiri - Administratori i Njesisë Administrative Kryevidh.
3. Deshir Gjumsi - Administratori i Njesisë Administrative Lekaj.
4. Denis Sako - Administratori i Njesisë Administrative Gosë.
5. Mexhit Saliu - Administratori i Njesisë Administrative Sinaballaj.
6. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
7. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
8. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
9. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
10. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Diasporës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
11. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
12. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
13. Megi Toska - Drejtore e Kadastrës.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Lorenc Boriçi - Kryeinspektor i policisë bashkiake.
16. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
17. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, **13-** Këshilltarë z. Enver Memolla i bashkohet në vijim mbledhjes së Këshillit.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përsëritet të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!



-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Erind Tosku, Shpati Kolgega, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Sokol Gosa, Besnike Coraj, Dhurata Meka, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që morëm në mbledhjen e këshillit të datës 18.06.2026 të cilët hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr . 23 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%.

Vendim nr . 24 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i pushtetit vendor.

Gjithashtu lexojmë dhe verifikimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për :

Vendim nr . 25 . datë 18.06.2026 “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.

Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit nr.414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Prefekti

Shkëlqim Hajdari

Mukades Gixhari . Tani kalojmë në rendin e ditës ...Atëherë kemi një propozim që sekreatri ju a shpërndau të gjithëve për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të bashkisë Rrogozhinë z. Agim Demrozi. Mund t'ju lexoj, apo e keni të gjithë?

Po jeni dakort ta përfshijmë në rendin e ditës tek të ndryshmet? Po zonja Fatmira Thartori.

Fatmira Thartori . Para kalon tek komisioni i titujve.

Indrit Dedej . Propozimi do të kalojë komisionin edhe çfarë kërkon komisioni në bazë të dokumentacionit që plotësohet dhe kalon në këshill.

Hekuran Xhani . Tai unë propozoj ku shkoi ai i Kryevidhit të ndryshojmë rendin e ditës që edhe ai të iki sepse ai tani është në periudhë më të angazhuar atje sepse shyqyr që e kemi atë



ndryshojmë rendin e ditës si më poshtë pika 10 miratim projekt vendimi për shtimin e punonjësve sezonal të plazhit” të kaloj pas ndihmës ekonomike dhe ndryshimi tjetër miratimi për përllogaritjen e nivelit të pagave edhe kjo të shoqërohet me pikën e tretë pas kësaj pastaj për të tjerat do të vazhdojmë sipas rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Jeni dakort të nderuar këshilltar për ndryshimin?

Indrit Dedej . Unë zonja kryetare edhe pse kam pak rezerva për punëtorët po nuk po jaja prish nënkryetarit, kurse për punën e pagave nuk jam dakord fare punëtrotë jam dakord për punësim sezonal.

Hekuran Xhani . Unë propozova Indrit vendimin e kryetares së grupit pasi dakordësia që arritëm megjithatë...

Indrit Dedej . O nënkryetar o kryetar unë kam thënë që e kanë diskutim pagat prandaj.

Hekuran Xhani . Aty pastaj është me votë ajo s'ka diskutim aty

Silvana Aliu . Sipas asaj që mendoj unë është një VKM që ky nuk mund ta kalojë...

Indrit Dedej . O Silvanë VKM-ja nuk mund të përdoret kur duan këto dhe si duan këto.VKM-ja përdoret unanimisht kur vjen trajtohet edhe veprohet jo kur të dua si dua nuk ka. Këtë mendoj unë. Ne nuk të bëhemi palë i atyre ...

Mukades Gixhari . Atëherë jeni dakort që do lëvizim pikën 10 ta kalojmë pas ndihmave ekonomike po për pikë 11 për llogaritjen e nivelit të pagave? Pastaj vazhdojmë me radhën ok. Atëherë miratimi i rendit të ditës e hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pikë e parë të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 12-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën dy Miratimi i procesverbalit numër8 të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 18.06.2026. E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro miratohet.



- Miratohet me 12-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë pikën tre. Miratimi i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muaj qershor 2026 nga fondi i ndihmës 6%. Fjala për drejtorin e mbrojtjes së kujdes social zoti Ledian Hasani. Përshëndetje zoti Ledian.

Ledian Hasani . Atëherë në total janë 17 familje që janë përfituese dhe fondi është 71.000 lekë të reja.

Mukades Gixhari . Atëherë në lidhje me pikën tre keni pyetje për zotin Ledian? Jo, atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim . Të gjithë pro. Miratohet.

--Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.26. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2926.Prot datë 14.07.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2926/1.Prot datë 14.07.2026.

-Kthehet në sallë këshilltari z. Shpati Kolgega gjithsej 13 anëtarë këshilli.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën katërt, Miratim i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muaj në korrik 2026 nga fondi i pushtetit vendor. Vazhdojmë po me zotin Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Në total janë 24 familje përfituese dhe fondi është 103.000 lekë të reja.

Mukades Gixhari . Komisioni është e ka shqyrtuar këtë pikë ? Keni ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro miratohet.

--Miratohet me 13 (trembëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.27. Miratohet me 13- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2925.Prot datë 14.07.2026, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin



shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2925/1.Prot datë 27.07.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor”. Fjala po për drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social.

Ledian Hasani . Atëherë këto janë kriteret për familjet që duhet të aplikojnë tek fondet e 6% ose edhe tek fondet e bashkisë kemi vendosur disa kriterë që kemi parë domethënë më të arsyeshme. Besoj që projektvendimin e keni përpara për çdo familje, domethënë çdo familje që do aplikojë do plotësojë disa dokumente që të jetë përfituese.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth pikës pesë për zotin Ledian? E hedhim në votim pikën 5, të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

--Miratohet me 13 (trembëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.28. Miratohet me 13- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2833.Prot datë 08.07.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2833/1.Prot datë 08.07.2026.

Ledian Hasani . Kalojmë në pikën 6, Miratim i projektvendimit “Për ngritjen e komisionit të strehimit”.

Ledian Hasani . Atëherë ky komision ka të bëjë me programet e strehimit social që do zbatohen në bashkinë Rrogozhinë. Një nga programet janë kreditë e buta, janë domethënë janë disa programe. Për këtë program kemi menduar që të ngrejme këtë komision. Kam menduar që në komision të jenë dhe dy përfaqësues të këshillit bashkiak. Pjesën tjetër pastaj e keni përpara, kanë të bëjnë me drejtoritë e bashkisë përfaqësues nga drejtoritë përfaqësues nga komunitet e interesuara. Emrat e këshilltarëve i vendosni vetë pastaj se i gjeni vetë.

Hekuran Xhani . Jo emrat do t'i propozojmë sot dhe do të miratojmë që...

Ledian Hasani . Emrat nuk është problem me i propozuar sot. Mund edhe një moment tjetër.



Hekuran Xhani . Jo jo i miratojmë sot edhe ti merri shënim ky është komisioni, t'i japim miratim nga këshilli .

Ledian Hasani . Unë dua një shkresë nga këshilli që këto dy persona domethënë do të jenë...

Silvana Aliu . Maxhoranca të vendosi vetë ne e kemi vendosur, Hekuran Xhani.

Indrit Dedej . Kisha qejf të çonim Tashën.

Hekuran Xhani . Dakord.

Ledian Hasani . Mendoj okej vendosni ju emrat po ta kalontë njëherë dhe prefektura si projektvendim pastaj mbrapa vendosni dy emra kë të doni ju më thoni .

Indrit Dedej . Ne nuk varemi nga Prefekti, ne nuk jemi “peqe-lepe” të prefektit ne nuk njohim fare kush është Prefekti, as nuk na hyn në punë fare as pjerdhim fare për Prefektin...

Mukades Gixhari . Të ruajme etikën e mbledhjes.

Indrit Dedej . Se unë jam këshilltar jam i votuar Prefekti është i emëruar, është një lëpirës i kryeministrit që është i votuar... Prefekti po të ishte dashamirës kishte ardhur këtu kur kishte rënë zjarri...

Mukades Gixhari . Z. Indrit ishim tek zgjedhja e anëtarëve të komisionit që kërkoi drejtori. Ju keni zgjedhur z. Hekuran Xhani ne në një moment të dytë pasi na mungon kryetarja e grupit. E hedhim në votim pikën 6, të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

--Miratohet me 13 (trembëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.29. Miratohet me 13- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2832.Prot datë 08.07.2026 “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2832/1.Prot datë 08.07.2026.

Mukades Gixhari . Tani siç e lamë pas pikës gjashtë do kalojmë në pikën 10 pastaj do t'i marrim të tjerat me radhë. Kalojmë në pikën 10. Faleminderit zoti Ledian. Miratimi i projektvendimit “Për shtimin e punonjësve sezonal plazhi me kontratë për periudhën Gusht



Shtator 2026” kemi administratorin e njësisë Kryevidh zotin Astrit Mërtiri. zoti Astrit përshëndetje.

Astrit Mertiri . Faleminderit. Përshëndetje të gjithëve! Duke qenë se njësia administrative Kryevidh është një nga njësitë më të mëdhaja dhe ka nevojë të domosdoshme për të, unë kam gjithsej 15 punonjës. Vija bregdetare është rreth 6 km. Janë 13 fshatra, janë 6189 hektar tokë, janë 20 palë varreza për t'u pastruar dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj të gjithë që jeni këtu që të shtohen punonjësit.

Silvana Aliu . Atëherë dakord mbështes atë që thotë dhe Alti, duke qenë se ne kemi bërë një kërkesë gjithmonë pothuajse po bëhen gjashtë muaj për drejtorinë e shërbimeve të jap informacion sa punëtorë ka gjithsej kjo drejtori nuk është vënë asgjë në dispozicion. Ta dimë sa punëtorë ka.

Altin Tosku . Ka katër muaj që nuk është në mbledhje fare.

Silvana Aliu . Ai e ka urgjente e kuptoj se është normale...

Hekuran Xhani . Tani në mbështetje të diskutimit të Silvanës jam plotësisht dakort ajo shefja që mbulon stafin e punonjësve të bashkisë duhet të vijë këtu të japi informacion përpara këshillit. Por çështja është emergjente për këto punonjës që merren me pastrimin e plazhit unë them herën tjetër ajo zonja të vijë këtu të na informojë dhe për gjithçka kërkon këshilli por kalojmë këtë kërkesën e njësisë administrative Kryevidh që të paktën mos bëhemi ne si këshillë shkak për pezullimin...

Silvana Aliu . Unë më fal lutem një minutë, unë e kaloj vetëm për faktin që administratori më tha që jam i gatshëm dhe jam transparent për emrat dhe ajo më pëlqeu.

Astrit Mertiri . Emrat gati jua sjell... Unë kam gjithsej 15 punonjës po ju them 15 punonjës, është njësia e dytë në republikë për sipërfaqe.

Silvana Aliu . Sa të duhen ty ?

Astrit Mertiri . Ore sa të jenë e di që 10 ka... Unë e kam bërë kërkesën për 30 veta domethënë kam 15 doja dhe 15 tjerë. Mirëpo tashi 10 dhjetë kur nuk ke pulën do hash sorrën. Jo jo ne vjet kemi pas kemi pasur 25 veta gjithsej.



Altin Tosku . Po pra 15 i ke, do dhe 15 shtesë.

Astrit Mertiri . Është vetëm varreza janë 20 palë, jam dakord , janë 13 fshatra.

Shpati Kolgega . Po këto tani do shtohen për turizmin?

Astrit Mertiri . Këto do shtohen për turizmin këto që do shtohen shtohen për turizëm. Por po them këto që kam 15 veta i çoj dhe atje.

Hekuran Xhani . O kryetar mos harxho më energji kështu, ta kalojmë miratimin e saj.

Mukades Gixhari . Kemi znj. Besnike Coraj.

Besnike Coraj . Unë do i thosha administratorit, unë nuk kam të kam parë ndonjëherë dhe nuk të njoh, disa herë kam dëgjuar që do kishe bërë mirë të kishe ardhur dhe më përpara...

Astrit Mertiri . Unë kam ardhur dhe përpara.

Besnike Coraj . Unë nuk të... nuk më kujtohesh nuk të mbaj mend .

Astrit Mertiri . Ja po të them është hera e katërt që unë vi këtu në mbledhje Këshilli. Po ama edhe unë po ju them kaq pavarësisht se në këtë moment unë jam hallexhi, jo jo jam hallexhi po kur dëgjoj këtu që ju ziheni për ca gjëra kot, unë nuk e di këtu është një gjë që është fakt.

Hekuran Xhani . Mos u bëj pjesë e jona.

Besnike Coraj . Kush i shikon këto pjesën e plazheve private plazheve publike, hapësirat këto punonjësit që do ti, se po të dëgjoj për varrezat një sekondë, varrezat janë tjetër gjë , ndërsa këto punëtorë që kërkon ti është tjetër gjë. Këto punëtorë në funksion të kujt i do? Të plazheve private apo të hapësirave publike.

Astrit Mertiri . Jo, jo plazhet private ... unë këto i dua për të pastruar pishat.

Besnike Coraj . Kjo pjesa e shazllonve, çmimet, gjërat?

Astrit Mertiri . S'kemi punë fare ne me ato.



Besnike Coraj . Kush i shikon?

Astrit Mertiri . Ato i ka bregdeti. Ka bregdeti. Nuk kemi ne punë.

Besnike Coraj . Kush i kontrollon këto?

Astrit Mertiri . I kontrollon policia.

Besnike Coraj . Cila polici të lutem, sepse unë shkoj paradite shazlloni jepet 10 mijë lekë, shkoj pasdite po i njëjti shazllon jepet 10 mijë lekë. A ka një kështu pa faturë, pa taksë, pa asnjë gjë. Shikoj gjëra, shikoj gjëra se jetojmë këtu. Këto punëtorë vëri ... hapësira publike janë mizerabël. Mizerabël kur thotë zotëria s'ka fare janë mizerabël.

Astrit Mertiri . Ka hapësira publike pafund.

Besnike Coraj . Unë nuk kam parë nuk dua, jo unë dua jo jo më fal më fal hapësirë private hapësirë publike, hapësirë private, hapësirë publike...

Astrit Mertiri . Po ashtu është.

Indrit Dedej . Nuk e ka fajin administratori në këtë mes këtu e ka fajin zyra e urbanistikës.

Besnike Coraj . Unë këtë e shikoj një zallamani që e paparë .

Astrit Mertiri . Atëherë meqë ju keni qenë, atëherë unë po ju them që unë këto njerëz i dua nga guri i lëmuar deri ku ndajmë me Vilën.

Besnike Coraj . Për hapësirat publike?

Astrit Mertiri . Për gjithë pishat, çfarë është pisha?- A është hapësirë publike?

Besnike Coraj . Të kuptoj për pishat hapësira publike. Jo ti çosh punëtorët të qëndrojnë në plazhet private.

Astrit Mertiri . Jo moj motër jo nuk ka nuk ka shanse ajo punë.

Besnike Coraj . Mos më thuaj se ne jetojmë këtu plazhin aty e bëjmë një jetë.



Astrit Mertiri . Po gjete një punonjës ti një punonjës të tonin të njësisë administrative Kryevidh që mund të jetë... Hajde hajde bëjmë transparencën bashkë në qoftë se një punonjës... nuk e pranoj... Se çfarë ke me bashkinë zgjidhe me bashkinë. Jo, jo unë e kuptova llogjikën që punonjësit e njësisë administrative punojnë tek plazhet private. Nuk ka shanse.

Besnike Coraj . Ok, shpresoj shumë. Shpresoj edhe unë kam parë gjithë ajo rrugë fantastike e mbytur nga balta e mbytur nga mbeturinat. Më ka ardhur keq kur kam kaluar për një xhiro për qejf dhe në dimër. Një baltë e paparë, makineritë punojnë. Jo, makineritë punojnë nuk kanë kontroll fare. Ç'janë këto makineritë e rënda hapin hapësira që bëjnë njerëzit të punojnë. Nuk ka një farë kështu, balka që në fyt rrugës, trotualet, bar dynjaja. Këto janë ato që ju si njësi duhet t'i sgikoni.

Astrit Mertiri . Unë kam dy vjet aty dhe o e kam fshiër me fshesë me ato pak punëtorë.. nga Grethi deri në Spille.

Fatmira Thartori . Unë isha para tre ditësh kam dalë deri në bregdet po pastrohej në dy anët me korrëse bari, isha para tre ditësh në Spille, isha në në plazh publik ishte xixë plazhi publik s'mund të them unë atë që s'është që atë që është bërë është bërë atë që s'është bërë...

Besnike Coraj . Të lutem gjërat t'i shikoj me kujdes zotëria, jo vetëm kërko kërko vini këtu vetëm kur keni për të kërkuar diçka edhe për të thënë edhe për të çfarë është bërë, si është bërë qofsha e gabuar edhe kjo që thotë të Fatmira mund të jetë e vërtetë. Edhe unë dy javë kam se ti e di që më ka ndodhur një fatkeqësi, unë e kam parë shumë keq rrugën, më vinte keq.

Hekuran Xhani . Fatmira jemi në këshill jemi dhe live tani humbim dhe seriozitetin tonë, tani ka ardhur kërkesa, jemi dakord ta votojmë?

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak dhe zotin Sokol se nuk ka folur fare.

Sokol Gosa . Një nga shqetësimi më të mëdha që duhet të kishim në këtë mbledhje të këshillit bashkiak është ajo që po ndodh edhe ishalla nuk bëht fakt, shkrirja e bashkisë tonë. Ne i kaluam për interes të komunitetit të gjitha këto dhe ndonjë pikë tjetër që ishte emergjente por pika të tjera, trajtime të tjera çështje të tjera për mua nuk ja vlen, para asaj që po ndodh me bashkinë tonë. Është me të vërtetë shumë shumë shqetësuese alarmante do të jetë me pasoja mjaft të rënda bashkimi shkrirja e bashkisë tonë me atë të Kavajës. Unë mendoj që të mblidhemi si këshilltar, një grup pune, një komision të bëjmë një protestë çfarë mund të organizojmë, ta diskutojmë së bashku sepse është më diskriminuesja nuk jemi pyetur absolutisht për këtë bashkim. Nuk ka



ardhur asnjë përfaqësues as i prefekturës, as i komsionit të forcës elektorale të konsultojë me komunitetin, me popullin, me ne këshilltarët e kësaj bashkie. Prandaj që unë mendoj që pikat tjera janë krejt krejt pa vlerë, se pse një nga rsyet e kësaj shkrirjeje është performanca e dobët e administratës së bashkisë. Një nga arsytet e kanë gjetur ato. Të gjithë fondi që marr nga andej shkon vetëm për paga, ku shkojnë këto të ardhura, ku shkojnë? Zotëria kërkon me të drejtë shtimin, po ku është ajo drejtoresha, ku janë? Sa punëtorë janë që nuk paraqiten fare në punë dhe marrë rrogën nga taksat tona dhe kjo është që arritëm në këtë pikë sa që nuk na llogaritën fare dhe me një të rënë të lapsit, bashkoje Rrogozhinën një qytet me tradita me kultura e të gjitha të gjitha se s'po i hyj historisë bashkoje me Kavajën. Kjo është ulëritëse ky është shqetësimi jonë, kaq kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit zoti Sokol, jemi te pika 10 të nderuar këshilltarë që mos dalim nga...E hedhim në votim pikën 10. Pika 10 që është me zotërinë me zotin Astrit Mërtiri e hedhim në votim Pro, kundra, abstenim atëherë...të gjithë pro. Miratohet.

--Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 10 (dhjetë) e rendit të ditës.

Vendim nr.30. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2856.Prot datë 08.07.2026 “Për shtimin e punonjësve sezonal plazhi (me kontratë) për periudhën Gusht-Shtator 2026”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2856/1.Prot datë 08.07.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7, të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029”.Relaton drejtori i financës z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Përsëndetje të gjithëve!

Mukades Gixhari . Ju lutem të nderuar këshilltarë, nuk duhet të largohemi nga mbledhja, mos u largoni nga mbledhja. Ta dëgjojmë drejtorin ka ardhur i përgatitur t'i shqyrtojmë pikat që kemi dhe për pjesën që foli profesor Sokoli do ta diskutojmë të gjithë bashkë.

Indrit Dedej . Kryetare s'keni takat atë që thotë Koli ta bëni ju, se njëherë e bëmë ne në 2015-tën.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë atëherë me rendin e ditës të dëgjojmë drejtorin e financës.



Rezart Vogli . Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 të bashkisë Rrogozhinë. Me miratimin e tavaneve, grupi i menaxhimit strategjik fillon shpërndarjen tek secili drejtues i menaxhimit të programit, me qëllim përgatitjen e kërkesave buxhetore përkatëse.

Mukades Gixhari . Pyetje, rreth pikës shtatë.

Indrit Dedej . Ju të majtët keni ndonjë pyetje ne e kemi ezauruar këtë pjesë.

Shpati Kolgega . Jo unë kam pyetje fare për këtë pjesë. Kisha një diskutim në raport me atë që tha Koli, sepse me profesorin, sepse me të drejtë normalisht para asaj që po ndodh ose pritët të ndodhë, të tjerat janë të rëndësishme së dytë të tretë ose më poshtë. Jo se s'jemi dakord me gjithë pikat e tjera, se kemi ardhur këtu për t'i votuar ato që duhen votuar, por që kjo që po ndodh besoj që duhet të na bashkojë të gjithëve të paktën për të qenë një mendje që a ka vlerë kjo që po ndodh për bashkinë Rrogozhinë, pra a ka a bën kuptim a është në interesin tonë në radhë të parë? Sepse gjëja e parë që do ndodhi është që ne si këshilltarë, pra nuk do ketë më një këshill bashkiak Rrogozhina mbase nga prilli, nga maji. Mund të jetë këshilli i fundit bashkiak që ka bashkia Rrogozhinë në historinë e vet dhe ne mund të jemi këshilltarët e fundit, por kur nuk ka këshill bashkiak s'do të ketë me as administratë. Pra dhe juristët që janë këtu do jenë në Kavajë. Më fal ta mbaroj, fundi është tani mund të jetë dhe fundi në kuptimin ...Unë bashkohem me atë që tha profesori sepse realisht domethënë kjo do ketë ndikim shumë të madh për të gjithë ne. Pra në qoftë se bashkia Rrogozhinë sot ka një administratë atë që ka, normalisht që pjesa e administratës do jetë aty ku do jetë bashkia nuk do jetë më në njësi administrative pra do zhvendosen punonjësit nga këtu deri në Kavajë vendimmarrja do jetë në Kavajë. Kavaja do ketë patjetër më shumë këshilltarë se ka më shumë votues se ne. Që do të thotë vendimmarrjet do jenë në dorë të atyre që janë me origjinë nga Kavaja më shumë sesa nga Rrogozhina, se Rrogozhina do prodhojë këshilltarë, por do prodhojë këshilltarë në minorancë në raport me gjithë këshillin bashkiak që mund të ketë bashkia e re, le ta quajmë në qoftë se do arrijë të bëhet në Kavajë. Kështu që normalisht interesi i tyre do jetë në radhë të parë për qytetarët e zonave të veta, të zonave të Kavajës, fshatrave të Kavajës, Kavaja ka shumë më shumë fshatra se ne. Prioritetet do jenë të vendosura kryesisht normalisht në dorën e tyre që kanë vendimmarrjen që do jenë nga Kavaja dhe për për Kavajën. Kështu që Rrogozhina është e padiskutueshme që do kalojë në plan të dytë ose madje mund të mos jetë fare në axhendën e bashkisë së re. Kështu që kjo është një situatë që ne të gjithë duhet mbase të ishim mbledhur në një mbledhje të jashtëzakonshme për ta diskutuar, të kishim thirrur dhe përfaqësues nga patjetër bashkia duhet të ishte e këtu sot me përfaqësimin më të lartë të vetin në fakt që nuk është më i larti këtu është administratori i njësisë Kryevidh kështu që mendoj që duhet zhvilluar një mbledhje e jashtëzakonshme që ne të kemi



mundësinë të flasim, të diskutojmë po në fund fare dhe për të kuptuar çfarë duan të bëjmë. Pra të kuptojmë mos është për mirë kjo që po ndodh sepse nuk e dimë realisht dhe unë vetë nuk e di do doja që të thelloheshim pak në këtë situatë. Kështu që mendoj që është në minimale që mund të bëjmë është të thërrasim një mbledhje, kërkojmë përfaqësues nga prefektura nga qeveria, bashkia patjetër do të jetë e gjitha këtu që të bëjmë një diskutim përmbajtësor se çfarë do ndodhi me qytetarët e bashkisë Rrogozhinë. Ne jemi përfaqësuesit e tyre, po nuk folëm ne të parët nuk kanë nuk kanë për të dalë as qytetarë për të folur askush tjetër. Kështu që mendoj që në rastin më të parë të zhvillohet një mbledhje e jashtëzakonshme dhe të thirren përfaqësues nga prefektura, nga qeveria dhe të zhvillohet një diskutim i hapur çfarë duan të bëjnë, çfarë do ndodhë, çfarë duhet të ndodhë me bashkinë, çfarë mendimi kemi ne, çfarë mendimi kanë qytetarët e bashkisë Rrogozhinë? Sepse kjo është më minimalja që duhet të ndodhë në këtë moment. Kështu që përtej kësaj unë nuk kam ndonjë koment për vendimet e tjera sepse këto janë...

Silvana Aliu . Atëherë unë jam dakort për çfarë the Shpat, por ty ta ka cilësuar bukur qartë pastër performanca e dobët e bashkisë. Ishim një nga bashkitë me performancën më të dobët.

Shpati Kolgega . Kjo është e vërtetë, ne jemi prezent këtu. Ka qenë bashkia me performancën më të dobët.

Silvana Aliu . A do ndryshojnë ato?

Shpati Kolgega . Por kjo nuk do të thotë që ne duhet të shkrijmë bashkinë sepse është bashkia me performancë të dobët, kjo është...

Indrit Dedej . Të vijë ai Prefekti këtu edhe të na japë shpjegime pse ne nuk dëgjohemi fare pse s'është dëgjuar , pse s'kanë ardhur si të gjitha rrethet e tjera, bashki të tjera që të mblidhen këtu të bëhet dëgjese publike.

Shpati Kolgega . Të shpjegojnë atë që po bëjnë në radhë të parë pra, sepse është një reformë që s'po merret nga ne po merret nga...

Indrit Dedej . Në qoftë se nuk do marrim vendim atëherë kot është.

Lulzim Hasa . Indrit të gjithë dëgjesat janë formale. Nuk është bashkuar vetëm bashkia jonë janë 10 bashki, ai është vendim politik.

Silvana Aliu . Po ne ishim më e dobëta ishim katastrofë.



Shpati Kolgega . A e kaluam?

Indrit Dedej . A do marrim një vendim për këtë?

Silvana Aliu . Do marrim vendim gjithsesi bëjmë një dëgjesë publike.

Shpati Kolgega . Të thërrasim mbledhje të jashtëzakonshme.

Lulzim Hasa . Kryeministrit e parlamentit , reforma zgjedhore u ka shkrirë reforma territoriale u shkri nuk funksionon më.

Silvana Aliu . Nuk po funksionon po nuk u bë asnjë gjë në Rrogozhinë as dëgjesë asgjë.

Lulzim Hasa . Unë i bashkohem të gjithë këshilltarëve të protestojmë.

Indrit Dedej . Po çfarë të keqe ka ankesë quhet kjo tek Prefekti.

Lulzim Hasa . Kryeministrit , parlamentit ...

Indrit Dedej . Pse e keni të vështirë me e kaluar?

Mukades Gixhari . Kush tha që e kemi të vështirë tashi po diskutohet ky muhabet mos thoni fjalën e fundit të parën, tani sapo u diskutua të bëjmë një mbledhje emergjente, ftojme të na vijne këtu dhe të na japin llogari.

Erind Tosku . Thjeshtë nuk bashkohemi me Kavajën çfarë llogarie duam ne.

Indrit Dedej . Pse nuk bëjmë dëgjesë, ne jemi përfaqësues të popullit, ne ngrejmë zërin e popullit, tani çfarë ka këtu për një mbledhje të dytë, një vendim aty një ankesë kërkesë quajeni si të doni.

Shpati Kolgega . Të behët një mbledhje e jashtëzakonshme të ftohen përfaqësuesit të ftohen qytetarët pra ne të jemi organizatorët e kësaj gjëje dhe ta iniciojm, duhet vendosur dataduhet të thirren me kërkesë zyrtare të gjithë institucionet që janë marrë , që nga minsitria e shtetit që ka bërë reformën.

Hekuran Xhani . Tani njëherë nuk është marrë vendimi për bashkimin.



Shpati Kolgega . Nuk është marrë vendimi por ka kaluar një draft...

Lulzim Hasa . Ka marrë fund...

Shpati Kolgega . Është miratuar një draft.

Silvana Aliu . Ai nuk ka marrë fund se të ka çuar katër skenarë ty.

Hekuran Xhani . Atje nuk është marurë vendimi pastaj qytetarët kanë të drejtën e vetëvendosjes. Ne organizojmë referendum bashkia të vendosin qytetarët. Hedhim firmat sa mijë banorë jemi. Thoe kështu ato këshilli do se do të rrijë këshilli pastaj ne jemi në konflikt interesi.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 7. Duhet diskutim tani për pikën shtatë.

Silvana Aliu . E dëgjuam por hidhe në votim.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim, pikën shtatë për miratimin e projektvendimit për miratimin e tavaneve përgatitore të shpezimeve të programeve buxhetore afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2027-2029. E hedhim në votim pro, kundra, abstenim nuk miratohet.

-Nuk miratohet pika 7 (shtatë) e rendit të ditës me 6 (gjashtë) vota pro, 6 (gjashtë) vota kundër.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “. Fjala për përgjegjësin e sektorit të pyjeve z. Artur Kaja. Përshëndetje z. Artur.

Artur Kaja . Përshëndetje të gjithëve ! Atëherë nga vetë emri ky është një plan masash që hartohet për parandalimin e zjarreve që mund të bien në pyje e kullota për sezonin 2026-2027 dhe çfarë punë ka bërë sektori i pyjeve për këtë qëllim. Në radhë të parë ne kemi drejtuar shkresa në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për krijimin e skuadrave vullnetar edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore . Tek fondi pyjor është i përfshirë nga zonat rurale në brendësi të pyllit rrugët parqet që gjelbërohen merret shërbimi mbështetës. Janë të ndara shërbimet mbështetëse merren me mbjelljen apo parqet në rrugë, shërbimi pyjor ka në sipërfaqet e fondit pyjor.

Indrit Dedej . Ne kemi një kryetar bashkie që është i emëruar u bënë 6-muaj , këto për të çuar



një listë Prefektit e bënë me vrap , 6 muaj ai ka të drejtë të shkojë në zgjedhje apo nuk ka të drejtë të shkojë në zgjedhje . Nuk e di kush do të na e shpjegojë se nuk jemi as juristë, kështu që nuk funksionojnë gjërat në momentin që nuk ke kryetar ... nuk është faji jot. Kryetari të vijë ne nuk e njohim ... i çoni letër KQZ-së.

Artur Kaja . Unë flas vetëm për fondin pyjor , shërbimet mbështetëse merren me gjelbërimin. Ky është plan masash për parandalimin e zjarreve.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Nuk miratohet.

-Nuk miratohet pika 8 (tetë) e rendit të ditës me 6 (gjashtë) vota pro, 6 (gjashtë) vota kundër.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 9, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë”. Fjala për znj. Kamela Shala koordinatore i informimit publik pranë bashkisë . Punonjësja nuk ka ardhur.

Kalojmë në pikën 11, Miratim i projekt - vendimit,” Për përlllogaritjen e nivelit të pagave për Bashkinë Rrogozhinë sipas vendimit Nr.103, datë 11.02.2026”. Fjala për drejtorin e financës z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Atëherë vendimi që paraqitet ka si qëllim zbatimin e vendimit numër 103 datën 11/2/2026 “Për përlllogaritjen e nivelit të pagave të funksionarëve, të nënpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të bashkisë së Rrogozhinë”. Nivelet e pagave janë përlllogaritur në përputhje me legjislacion në fuqi dhe tabelat përkatëse. Ky projektvendim nuk krijon funksione të reja dhe nuk ndryshon strukturën organizative të bashkisë. Ai vetëm zbaton kuadrin ligjor në fuqi. Projektvendimi nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë pasi fondi i pagave është planifikuar dhe është miratuar në buxhetin e vitit 2026. Për këtë arsye kërkon Këshilli bashkiak miratimin e projektvendimit.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje keni në lidhje me pikën 11?

Shpati Kolgega . Më fal, konkretisht si ndryshojnë pagat pra si shtohen besoj rriten? Pra kush rritet sa rritet?

Rezart Vogli . Patjetër për pjesën e drejtuesve ka indeksim pagës 2,5% sipas... kurse për pjesën e policisë bashkiake dhe disa funksione specifike siç janë hidraulikë, elektrikë, manovratori rritet me 70 mijë lekë të vjetra paga domethënë e kemi çuar në kufirin maksimal sipas përcaktimeve ligjore.



Hekuran Xhani . Tani jemi dakord që çështja që i shërben administratës të jetë në shërbim... Por kam një kërkesë ndaj administratës, duhet të jetë më efikase, duhet të jetë më e angazhuar në shërbimet me qytetarët, kryesisht dhe veçanërisht zyra e bujqësisë duhet të merret më shumë me çështjen e fermerëve të kësaj bashkie. Ky është një vit i mbrasthtë sepse prodhimet e fermerëve po ngelin nëpër parcela. Dhe unë desha të theksoj këtu për pagat minimale të punonjësve sa janë dhe sa rriten?

Rezart Vogli . Pagat minimale për disa pozicione specifike siç janë policia bashkiake...

Hekuran Xhani . Po të marrin e fundit fare është një punojë skrepi që ka qenë dje nga Luzi sa është paga e tij dhe sa rritet?

Rezart Vogli . Ka qenë paga 50 mijë lekë që ka qenë e zbatueshme me vendim Këshilli i Ministrave dhe shkon sipas vendimit numër 103, 57 mijë lekë bruto.

Hekuran Xhani . Sa lekë merr ai aktualisht?

Rezart Vogli . Ai aktualisht merr 446 mijë lekë neto, me ndryshimet e reja do i shkojë diku tek 50 mijë lekë.

Hekuran Xhani . Pak sepse nuk ka një punojë që të paktën të merret me çështjen e fermerëve, janë ato dy skrepat një është rri në Shkozë ka dy muaj që fle gjumë edhe ky tjetri që faktikisht unë jam 65 vjeç unë nuk shkoj në punë të shtetit për 450 mijë lekë ju garantoj me përgjegjësi kudo të më çoni dhe ministër me pagë 450 mijë lekë unë nuk shkoj në punë. Tani ai ka një përgjegjësi të madhe sepse ai gjendet i duhet fermerit çdo ditë nëpër fushë nëpër parcela sepse fermerët po pastrojnë kanalet me parat e veta mirë prodhimi nuk po i shitet, po për të vaditur edhe atëherë duhet me marrë skrep privatisht për të bërë kanal. Pra unë jam që pagat të rriten, po veçanërisht të shihen dhe të specifikohen a shpërblim a ndonjë gjë se ai dy rrugë ka. Atëherë ai ishte i ri kur unë plak nuk rri me 450 mijë lekë ai jo do të shesë naftën ose do të iki të punojë privat. Prandaj t'i rrisim pagën dhe të rrisim kërkesën e llogarisë.

Rezart Vogli . Projektvendimi e shtrin efektin financiar nga data 1 janar 2026. që do të thotë për muajt që kanë kaluar çdo punonjës që i rritet paga do marrë pjesën e efektit financiar që i takon.

Hekuran Xhani . Unë gjithmonë në çdo miratim buxheti i kam kërkuar pagë maksimale për administratën. Në moment që ke një administratë të paguar mirë të shëndoshë mirë financiarisht eliminon edhe korrupsionin, por ama administrata duhet të jetë më koherente me qytetarët dhe



kryesisht edhe me këshillin të vijë të raportoje dhe të bëjë transparencë për punën e saj. Jo ka dërguar ajo shefja që thotë Altini nuk vjen këtu, ajo është e shërbimeve ajo është një ndër drejtorit ma merr mendje më kryesore, të vijë të informojë çfarë është duke bërë bëhet çfarë po bëhet, unë për vete jam dakord për rritjen maksimale maksimale maksimale të administratës dhe kërkesën e llogarisë.

Silvana Aliu . E kanë të zgjidhur problemin për rritjen e atij të skrepit sepse mund të heqin 100 punëtorët që i kanë dhe nuk i shkojnë asnjë ditë në punë dhe mund t'ia shtojnë pagën atyre. E kanë mundësinë.

Indrit Dedej . T'i japë orë shtesë të ja çojë 3 milion.

Hekuran Xhani . Thashë më tha xha unë paguam kaq.

Indrit Dedej . 470 mijë lekë je dakord ti?

Hekuran Xhani . Sa t'i japë ligji maksimalen ne nga xhepi tani

Silvana Aliu . 470 atyre 1 milion për këshilltarëve të kryetarë që nuk i dimë se kush janë.

Hekuran Xhani . Për transparencë por kjo shefja që na duhet për transparencën nuk na erdhi.

Silvana Aliu . Nuk na kanë ardhur as shefat e tjerë. Këto që vijnë përherë ato vijnë.

Altin Tosku . Atëherë duhet më shumë transparencë për mendimin tim dhe më shumë është rritja e pagës së punëtorëve më shumë, duhet të jetë më shumë se sa kjo kurse të tjerat ...

Mukades Gixhari . E hedhim në votim Pro , kundër abstenim?

Altin Tosku . Unë nuk jam dakord për vete. Po s'jam se i rritet vetëm vetëm kur i thuhet top modelëve nuk i rritet atij që rri gjithë ditën tek kanali.

Mukades Gixhari . Nuk miratohet .

-Nuk miratohet pika 11 (njëmbëdhjetë) e rendit të ditës me 7 (shtatëtë) vota pro, 5 (pesë) vota kundër.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 12, Raport nga administratorët e Njësive mbi punën e bërë përgjatë periudhës Janar-Maj 2026, kishim të pranishëm vetëm z. Astrit Mertiri i Nj. A Kryevindh të tjerët i shtyjme për mbledhjen e ardhshme.

Shpati Kolgega . Nëse nuk miratoni asgjë pse na lodhni kot ta marrim vesh?

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 13, Raport mbi punën e bërë nga drejtoria juridike pranë bashkisë Rrogozhinë. Fjala për përgjegjësin e zyrës z. Luan Gjuzi.

Luan Gjuzi . Raport për drejtoinë juridike për vitin 2026 ju e keni marrë më përpara dhe e keni dëgjuar unë po ju lexoj shkurtimisht : drejtoria juridike përbëhet nga katër sektorë, sektori juridik, sektori i burimeve njerëzore, sektori i marrëdhënieve me publikun dhe sektori i IT-së. Sektorët ushtrojnë detyrat në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe rrugulloren e bashkisë së Rrogozhinës. Sektori juridik puna e sektorit juridik për bashkinë është mbështetur në kuadrin ligjor ligjin organik 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , dhe në detyrimet që rrjedhin nga rregullorja e bashkisë. Për periudhën kohore që po raportojnë qershor 2025 - maj 2026 sektori juridik ka qenë një punë të zbatimeve të procedura ligjore të specifikuar në rregullor e brendshme të bashkisë dhe në zbatim të akteve normative nga kryetari i bashkisë. Sektori juridik për periudhën qershor2025- maj 2026 për çdo muaj ka hartuar plane specifike periodike pune dhe bazuar në planet mujore të miratuara sektori juridik ka ndjekur zbatimin e planeve mujore të punës të miratuar nga eprori për çdo muaj pasardhës dhe ka bërë analizë punën në funksion të realizimit dhe objektivave të përshkuara në planin e punës duke përcaktuar detyra në vijimësi për çdo problematikë të dalë. Veprimtaria e sektorit juridik ka qenë i kushtuar në dhënien e konsulencës ligjore në përmbushjen e detyrave të drejtorive të bashkisë me hartimin e projekt prokurave të posaçme për marrjen e pensionit në postën shqiptare dega Rrogozhinë, marrëveshjen bazuar në marrëveshjen që ka në marrjen e masës pajtimit kontraktore që ka me të tretë ndaj bashkisë dhe të kundërt që kontrata ose marrëveshje ku bashkia është palë kontraktore. Gjithashtu dhe proceset gjyqësore që ka pasur për periudhën Qershor 2025 dhe qershor 2026. Të jua lexoj e keni materialin?

Indrit Dedej . A mund të na shpjegosh ti si zyrë juridike kur një person bën kërkesë, bën kontratë me firmën e tërmetit edhe nuk ke lejen ndërtimit ose nuk përgjigjet fare ajo zonja që bën kontratën, ka një zgjidhje kjo si ...?

Luan Gjuzi . Tani bën kontratë nuk përgjigjet për kontratën...?

Indrit Dedej . Ka bërë kontratën për rindërtimin e shtëpisë.



Luan Gjuzi . Edhe pse nuk kam qenë pjesë e asaj strukture dhe kjo kompetencë është e titullarit të bashkisë dhe drejtorisë së financave. Po them që mundet edhe të mos ketë ardhur buxhetimi nga ministria e financës për personin.

Indrit Dedej . Unë e di sepse është zinxhir nuk bëhet kontrata në qoftë se nuk jepet leje se është zinxhir.

Luan Gjuzi . Jo, edhe njëherë bëhet kontrata çelet fondi zbardhet leja ndërtimit.

Indrit Dedej . Pra është bërë kontrata gruaja huaj s' ja hap telefonin e shkon në bashki s'i japin zgjidhje. Tani hajde kush do e zgjidhi.

Luan Gjuzi . Kontrata bëhet në fillim çelet buxhetimi nga Ministria e Financave për personin x.

Indrit Dedej . Po s'mund të bëhet kontrata apo s'u çel.

Luan Gjuzi . Fillesat janë kontrata pasi është përfitues bëhet kontrata dhe në momentin që çelet nga Ministria e Financave buxhetimi fillon investimi.

Indrit Dedej . Tani ku do shkojë qytetari?

Luan Gjuzi . Qytetari vetëm tek ministria e financave dhe tek drejtoria e financës tonë. Drejtoria e financës bashkërendon punën me ministrinë e financës për buxhetimet bën kërkesë kaq edhe buxhetimi bëhet me emër personit x personit x personit ypsilon se s'po i përmend emrat dhe në atë moment personi bën një marrëveshje me një subjekt ndërtues, i kalojnë lekët atje subjektit ndërtues dhe fillon punën.

Indrit Dedej . Po ku e dimë ne që si kanë kaluar lekët?

Luan Gjuzi . Këtu është drejtoria e financës pastaj.

Indrit Dedej . Jo nuk i hap telefonin pastaj, tani a po bën iniciativë kryetari që të shkojë në polici t'i bëjë denoncim kësaj firmës?

Luan Gjuzi . Unë po them me njohuri edhe pse nuk jam pjesë e asaj strukture, kam njohuri se si funksion, s'jam pjesë thashë kam njori se si funksionon aq sa kisha njohuri...



Indrit Dedej . Tjetër në lidhje me kontrollin e brendshëm të shtetit. Ne kemi kërkuar kërkuar që të na vijë në dispozicion raportin.

Luan Gjuzi . Në qoftë se bashkia Rrogozhinë nuk i jep i keni tek KLSH-ja.
Indrit Dedej . Jo KLSH-ja i nxjerr një herë në vit.

Luan Gjuzi . Jo jo i ke të gjitha. Unë i kam i kam parë vetë.

Silvana Aliu . A është e drejtë nga punëtorët e juaj të drejtorisë juridike në momentin që ne vijmë kërkojmë informacion dhe thotë që nuk e jap informacionin se është konfidencial?

Luan Gjuzi . Ka që janë konfidencial.

Silvana Aliu . Kush kontratat, tenderat janë konfidenciale ?

Shpati Kolgega . Ka një raport të vitit 2024.

Indrit Dedej . Po raport 25 , 26 ku i ke? Kontrolli i lartë i shtetit i le raport kryetarit të bashkisë, kryetari i bashkisë dhe kryetarit të këshillit bashkiak.

Luan Gjuzi . KLSH nuk vjen vit për vit, vjen si puna ime siç erdha 2025- 2026 edhe ato e kanë 2024-2026.

Silvana Aliu . Kur e kërkon këshilli është problem kur e kërkon këshilli raportin ndërsa atyre i ka shkuar raporti sepse ju kanë gjetur me performancë të dobët.

Indrit Dedej . Zotëri je i detyruar të ma sjellësh nuk më hyn në punë kontrolli i brendshëm i juaji që i bie valles së kryetarit.

Luan Gjuzi . Edhe qëparë e thashë Bashkia Rrogozhinë nuk ka performancë të dobët. edhe ju nuk duhet të pajtoheni.

Silvana Aliu . Që e keni performancën dobët e keni dobët ju.

Luan Gjuzi . Po ta flasësh dhe për bashkitë që janë këtu, bashkia e Peqinit ka 6-muaj pa marrë rrogat, bashkia e Kavajës kaloi në faliment. Kaloj në faliment në administrim.



Silvana Aliu . Një nga pikat që bashkia e Rrogozhinës do bashkohej me Kavajën ishte performanca e dobët e bashkisë, ore e kanë thënë ato ju kundërshtoni thëniet e tyre. Ne e dimë që jeni të dobët.

Luan Gjuzi . Unë e mas nivelin me bashkinë e Peqinit e mas nivelin me ish bashkinë e Kavajës .

Silvana Aliu . Bashki, bashki që rri në kafe gjithë ditën kjo është performanca, gratë vishen pispilloren me funde me gjëra si top modele në kafe, i ke dhe fotot e drejtorive bosh pa asnjë punëtor.

Shpati Kolgega . Tani performanca e bashkisë nuk matet as nga orari as nga veshja ka disa elementë të tjerë.

Indrit Dedej . Për 2024 për transferencë ke mundësi të ma sjellësh?

Silvana Aliu . 6-muaj ke fituar tenderin e rrugës ...

Shpati Kolgega . Po mundohem që thjesht të them që performanca nuk matet as nga orari as nga kafja ...

Silvana Aliu . Edhe atë parkun që e nxirrni foto e kënaqni foto është e mbushur ...

Luan Gjuzi . Dëgjo mua ajo teknologjia më ka kapur me vonesë.

Shpati Kolgega . Nejse nuk është struktura e duhur për të adresuar këto se...

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Luan. Kalojmë nepikën tjetër, njohja me shkresën kthim përgjigje drejtuar kryetares së grupit të djathtë zonja Silvana Aliu nga Drejtoria e politikave urbane.

Indrit Dedej . Kryetar po për raportin e administratorit ku i ke administratorët?

Silvana Aliu . S'kanë ardhur.

Mukades Gixhari . E diskutuam e kaluam ...

Shpati Kolgega . Pse i fusni në rend dite kur...



Mukades Gixhari . Janë njoftuar ato ...

Shpati Kolgega . Edhe s'ka gjë domethënë le të vazhdojmë, vazhdojmë sikur s'ka ndodhur asgjë. Ka ndonjë arsytim që nuk kanë ardhur? Nejse nuk është normale të paktën mos e vini se është dhe për turpin tonë që vijmë këtu e nuk vjen askush për të raportuar mos e fut fare në rend dite.

Silvana Aliu . As shqyrtimin e kërkesës së Mitatit nuk ke se nuk kanë ardhur drejtorat.

Mukades Gixhari . Për këtë nuk është as z. Mitat vetë.

Shpati Kolgega . Komisioni është ngritur nga këshilli nuk është se ka ndonjë gjë për të diskutuar këtë që kanë sjellë.

Hekuran Xhani . Kjo është mungesë e seriozitetit të drejtuesve të njësive administrative nisur dhe nga diskutimet e parafolësve po bëhet afër një vit që ne kemi edhe një Prefekt të ri si qark Tiranë ku bashkia jonë varet edhe ai s'u pa një herë të paktën për prezantim në këshillin bashkiak, kështu që meqë ai nuk erdhi me iniciativë e me dëshirë t'i bëjmë një kërkesë atij prefektit, të na vijë të paktën mbledhjen e ardhshme aty ku ne mund të diskutojmë edhe mbi ndryshimet e ndarjes territoriale. Na informoi ai se është pjesë e qeverisë edhe të vijë të paktën ta njohim nga afër, unë kam pasur respekt si punonjës drejtësie për atë, po vallahi tani e kam humb atë respektin duke qenë prefekt dhe të mos vijë njëherë një vit se s'ka 100 bashki Tirana 10 bashki ka që duhet të ishte prezent. Tani unë nuk jam në dispozicion t'i shkoj asnjërit i shkoj një miku për kafe. Po ne duhet të respektojmë seriozitetin themi mos priset bashkia, po një bashki që nuk vjen njëherë prefekti unë s'jam dakort.

Mukades Gixhari . Kemi pikën 16 informacion për evidentimin e problematikave të institucioneve arsimore dhe marrjen e masave për rregullimin e tyre për të pasur kushte sa më optimale për vitin e ri shkollor 2026-2027. Mungon drejtori e arsimit të kulturës, turizmit.

Hekuran Xhani . Mos e vazhdo kot mbledhin tani këto mungojnë të gjithë.

Mukades Gixhari . Kemi zonjën Marsida këtu dhe zonjën Dafina që janë pikat 17 dhe 18. Shqyrtimi i materialit analizë mbi realizimin e treguesve të ardhurave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 nga drejtorja e të ardhurave dhe e zhvillimit ekonomik. Fjala për drejtoreshën e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik zonja Marsida Thartori.



Marsida Thartori . Përsëritje! Si jeni? Meqënëse Silvana na akuzoi për performancë të dobët, ta ngrejmë një çik këtë performancën dhe ta çojmë në nivelin e duhur. Kemi punuar, nuk është se s'kemi punuar. Është një performancë që nuk ka ndodhur asnjëherë që në gjashtë mujor të kemi këtë realizim të ardhurash. Janë diku tek 82% më tepër se gjashtë mujori i vitit kaluar.

Silvana Aliu . Mos i keni futur nga xhepi juaj?

Marsida Thartori . Jo, jo pa merak se janë 57 milion lekë të reja dhe nuk i fusim dot nga xhepi. 57 milion lekë... Okej që mos të bëjmë shumë fjalë. Unë i kam sjellë me grafik dhe te grafiku i parë me blu paraqitet plani, me portokalli të kuqe kemi faktin e 2026-s. Me të verdhë kemi faktin e 2025-s ku dhe nga grafiku tregohet që është rritur është rritur realizimi i të ardhurave siç e thashë në një vlerë diku te 82.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe nga plani në gjashtë mujor jemi me një realizim 47% të të ardhurave.

Shpati Kolgega . Ta bëj një pyetje, më fal edhe njëherë se s'po e kuptoj. Sa është 25 sa është 26 ? Pra është 69 milion 25?

Marsida Thartori . Ka qenë 25 në gjashtë mujor këtë vit është 127, në gjashtë mujor. Po janë diku te 50 e ca milion le më tepër 82.5%.

Shpati Kolgega . Çfarë ka ndodhur që është kjo rritje kaq e madhe?

Marsida Thartori . Janë rritur të gjithë zërat por një ndër zërat që është rritur më shumë është dhe ndikimi në infrastrukturë në tabelën e dytë.

Indrit Dedej . Kanë qenë lokalet pa licensa pa letra, janë marrë këtë vit. Për këtë do të bëj një pyetje unë zonjës sa biznese në bregdet ka që aktualisht nuk kanë leje?

Marsida Thartori . Procedura e bregdetit është mbyllur me rreth 85% e punës.

Indrit Dedej . Po sa keni verifikuar ju në terren se jeni drejtoresha e taksave.

Marsida Thartori . Unë kam ngritur task forcën dhe e kam aktualisht në terren, por nuk e kanë mbyllur akoma procesin e inspektimit, janë në terren. Kam ngritur urdhërin në mes të qershorit dhe po vazhdon me auditimin në terren. Tek faqja e tretë unë të kam marrë zërat çfarë të ardhurash ka ndryshuar dhe si është diferenca për çdo të ardhur. Po në këtë vit janë mbyllur gjithë kontratat janë paguar 95% e kontratave janë paguar ka ngelur një 5% që i kanë pasur



kontratat nga vjet dhe i kanë aktive dhe këtë vit që kanë afat t'i mbyllin brenda sezonit turistik. Jo nuk i ke të ardhurat vetëm nga këtu po t'i shohësh tabelat ... Unë do të jap urdhërin e grupit të punës.

Indrit Dedej . Po nuk besoj se s'kam urdhër kështu që... edhe ti nuk je në gjendje të më thuash se sa biznese ke pa licencë?

Marsida Thartori . Biznese pa licencë stacione plazhi thua? -Asnjë nuk operon pa licencë. Asnjë stacion plazhi nuk operon pa licence.

Fatmira Thartori . Po të jep dhëna të sakta të jep dhëna të sakta. Po t'i jep të përpikta.

Shpati Kolgega . Performanca e buxhetit të bashkisë ka rritje goxha të madhe. Taksa e ndikimit në infrastrukturë pra nga sa subjekte po them, apo nga sa leje është...?

Marsida Thartori . Tre.

Shpati Kolgega . Pra janë tre leje ndërtimi në Spille që e kanë rritur këto performancë.

Marsida Thartori . Tek hapësira publike krahasuar me 2026-ën se po më thojë për hapësirën publike nga stacionet e plazhit nuk është ndonjë rritje e konsiderueshme. Ka qenë pak a shumë në të njëjtat nivele nuk është vetëm nga vetëm nga stacionet e plazhit. Çdo zë ka ndikuar në rritjen e të ardhurave, por peshën më të madhe 38% e të gjithë të ardhurave e zë ndikimi në infrastrukturë. Diferenca pastaj është nga nga zërat e tjera. Po të gjithë zërat janë në rritje, qoftë taksë e ndërtesës, taksë e tokës buësore, tarifë e pastrimit, tarifa e tjera.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Mbledhjes ju bashkua zoti Enver Memolla. Kalojmë në pikën 18, Shqyrtimi i materialit përgjigje të ardhur nga Shoqëria rajonale e Ujesjellës Kanalizime Durrës mbi treguesit kryesorë ekonomikë të njësive operacionale Rrogozhinë. Fjala për drejtoreshën e njësive operacionale Rrogozhinë zonja Dafina Nuka. Përshëndetje zonja Dafina, fjala për ju.

Dafina Nuka . Tani në bazë të shkresës dërguar drejtorisë rajonale Durrës me numër protokolli 2148 datë 29.6.26. Ato zotërinjtë e kanë parë kërkesën tuaj dhe mbas kërkesës kanë kthyer një përgjigje për performancën e ujesjellës kanalizime Rrogozhinë. E para fillon me pika e parë se kanë përmbledhur domethënë shkurtimisht me e kanë dhënë tabelaren që ju bezdis besoj ta lexoj gjithë tabelën. Informacioni është përmbledhës dhe Shpatin që e kam këtu afër mund ta lexoj dhe



përmbledhës, mund të ma diktojë pak se edhe syzet më mungojnë sot se isha në terren.

Shpati Kolgega . Shiko tani na e thuaj me pak fjalë...

Dafina Nuka . Jo është thjesht është thjesht informacion për punën. Atëherë njësia operacionale Rrogozhinë operon gjithë bashkinë Rrogozhinë me ujë dhe kanalizime, 20% domethënë mbulohet me kanalizime vetëm në qytetin Rrogozhinë pak Gosa qendër dhe pak një pallat i vetëm në Vilë Ballaj. Krahas problematikave që ka sektori, njësia jonë ka pasur një ecuri të qëndrueshme dhe në rritje gjithë kohën ka qenë në rritje treguesit tanë duke filluar nga kontratat nga të ardhurat nga që domethënë është shitja nga arkëtimet jemi me mbi 100% tek të gjitha, vetëm tek kontrata e bizneseve jemi 99.1% sepse në bashkinë tonë bizneset përqëndrohen në zonat rurale, bregdetare, bregdetare, jo rurale, më falni. Dhe bregdeti jonë ka nuk ka investim për ujësjellës, për ujin e pijshëm, operojnë me puset e veta, me shpimet e puseve, mund ta dinë shumica. Ndërsa institucionet dhe familjarët e kemi 102 kemi familjarët dhe 100% kemi institucionet 113%. E të gjitha shkon 100 e kam këtu 102, e kemi institucionet jo 100% kemi institucionet 102 kemi familjarët dhe 99.5 kemi bizneset. Faturimi është në rritje, buxheti ka qenë 32. Viti 2025 e ka pasur 32 dhe buxheti ka qenë i planifikuar 29 dhe ne kemi kaluar 108.8%, në të ardhura. Ato kanë planifikuar një buxhet për 29 ne e kemi realizuar me 32% domethënë i gjithë realizimi është 108.5, ndërsa të ardhurat tona besoj e keni të gjithë përpara të ardhurat i kemi 114% në krahasim me buxhetin e planifikuar .

Hekuran Xhani . Shumë mirë tek të ardhurat, i ke shërbyer shumë mirë asaj drejtorisë rajonale të Durrësit. Si je me furnizimin, oraret me ujin me qytetarët, kjo na intereson ne sa ujë marrin qytetarët?

Dafina Nuka . Rrogozhina është me ujë të pijshëm furnizim 24 orë ? Rrogozhina si qytet.

Fatmira Thartori . Po njësitë?

Dafina Nuka . Sivjet është viti që nuk ka pasur problematika në Gosë. Kemi bërë ca manovrime ndërhyrje sepse ne jemi në investim në Gosë. Po t'i shikosh rrugët e Gosës janë akoma rrëmujë se jemi me një investim të ri, por kemi bërë ca manovrime në orare që të marrim të gjithë domethënë që mos ngelet asnjë pa furnizim. Kalushi, kërçukaj...

Silvana Aliu . Përsa i përket Rrogozhinës përgëzime për punën edhe furnizimi është super pro propozoj dhe për diçka tjetër që punëtorët t'i keni në terren për çdo gjë jashtë...



Dafina Nuka . Edhe atë do ta them që punëtorët e mi punonjësit e mi pa mjete përkatëse domethënë që duhen për punën por janë korrekt me punën dhe i kanë të gjithë në terren.

Silvana Aliu . Kemi dhe një vërejtje të vogël për në Spille tek urgjenca spitali.

Dafina Nuka . Do ta shpjegoj dhe pjesën e spitalit jo më larg jo më larg se e kam edhe unë atë e kam çuar edhe dje që ka qenë e dielë ka shkuar punonjësi im atje ka verifikuar ka shkuar një po ta shikosh videon ka një nga ana e bashkisë ka shkuar një depozitë atje uji shkon deri këtu dhe atje duhet punonjësit e shërbimeve të ndërtesës që të hapin linjat se i kanë bërë shumë keq që uji t'i shkojë te depozita. të bëhet lidhja e depozitës.

Silvana Aliu . Bashkëpunoj me administratorin se mori 10 punëtorë sot edhe besoj se do jenë ...

Dafina Nuka . Astriti ka qenë një nga domethënë bashkëpunëtorët e mi në terren në çdo hap domethënë... nuk e di kush e ka hidraulikun njësia këtu domethënë bashkia apo njësia administrative sepse unë e kam çuar hidraulikun po s'është problemi jonë.

Fatmira Thartori . Faleminderit zonja kryetare, unë jam e kënaqur për lagjen time për Kërçukaj për qendrën gjithashtu po Gosën e madhe lart sepse unë atje kam shtëpiat e mia gocë dhe atje është problematikë sepse takim gjatë periudhës që vijnë refugjatet uji vetëm të merret me pomë thithëse.

Dafina Nuka . Po sepse është investim i vitit 2001 dhe sot neve jemi edhe në Gosë. Në këto momente që ne jemi këtu, grupi i punës është në Gosë.

Fatmira Thartori . Edhe dua të them që a do rregullohet këtë vit ?

Dafina Nuka . Patjetër se para para një mos gaboj një muaj tre nuk e kam mbushur muajin kemi bërë një takim me firmën që po bën punimet në bashkinë Rrogozhinë, nuk e di kush ka qenë dhe ato i kanë lënë, ka qenë AKUK-u, kam qenë unë, ka qenë dhe drejtori i Durrësit rajonal dhe kemi vendosur që i kemi lënë një afat kohor firmës që brenda muajit mbyllet Lekaj dhe Gosa. Mirëpo unë e kam ndjekur vetë hap pas hapi dhe në Lekaj zysha duhet ta dijë është mbyllur, është bërë gati thjesht vetëm t'i shkojë uji banorit në familje. Gosa ka filluar ka mos gaboj pesë ditë. E vjetra është akoma, e reja se do bëhet është bërë dhe një testim do jetë brenda këtyre periudhave tani një muaj, dy muaj nuk zgjat domethënë varet tani si do operojnë ato në Gosë.



Fatmira Thartori . Gjatë kësaj periudhe që është periudha verore dhe që vijnë refugjatët a do të jetë stabilizuar pjesa e Gosës së madhe?

Dafina Nuka . Do jetë gjithë zona me një investim të ri të vetëm, se testimet janë bërë janë kryer une kam qenë vetë në testim uji është shumë në rregull dhe ka një gjë të mirë në krahasim me qytetin Rrogozhinë.

Fatmira Thartori . Pra pse ka mungesë uji i lart?

Dafina Nuka . Po ka se është zonë malore dhe nuk i shkon, nuk ka aq ka, ne kemi shtuar për paraprakisht para se të vijë investimi ne nga Çërma kemi bërë një pikë ataku në rrugë kam qenë vetë prezent dhe ne e kemi shtuar me 5 l sekondë dhe prap nuk e furnizon dot se është linja e vjetër.

Hekuran Xhani . Po Lekajn pse e ke lënë jashtë bashkisë.

Dafina Nuka . Po se kam lënë unë, e kanë lënë ata që kanë bërë projektimin . Do jetë investim që do futet në punë dhe do mbulojë Gosë dhe Lekaj dhe gjithë malësinë. Po ato e kanë kështu Silvana dhe juve të gjithë e kanë nëse ne marrim vendimin për jo si këshill bashkiak ato nëse e kanë vendosur, e kanë vendosur.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në pikën 11 shqyrtim i shkresave të ardhura nga Drejtoria e Kenancës. Kërkesë për shtyrje afati për paraqitjen e analizës për realizimin e treguesve ekonomiko financiarë për gjashtë mujorin e vitit 2026. Mbi mosmaratimin e tavaneve të programit buxhetor afatmesën PBA 2027-2029. Shkresa kthim përgjigje me numër 2660 i drejtuar Ministrisë së Financave dhe për dijeni këshillit bashkiak. Drejtori i financës do të na shqyrtojë me radhë këto tre shkresa. E keni te rendi ditës, duhet ta keni lexuar nuk është projekt vendim.

Rezart Vogli . Duke qenë se na erdhi një shkresë për dorëzimin e raportit financiar janar-qershor 2026 dhe afati i dorëzimit të këtij raporti ishte data 10 korrik. Është e pamundur për shkak të afateve, për shkak të situatës që ka dhe puna dhe vështirësi që kanë për rakordime, të ardhme, shpenzime, investime dhe të gjithë të tjerëve. Për këtë arsye i kërkuam këshillit bashkiak që raportin ta dorëzojmë në mbledhjen e muajit korrik, kështu në muajin gusht në mbledhjen e muajit pasardhës të vi dhe raporti për shpenzimet gjashtë mujore. Siç bëri drejtoria e të ardhurave relacionin për të ardhurat dhe unë kam relacionin për gjithë 6 mujorshin. Dhe ishte e pamundur pasi deri brenda datës 10 Korrik bëhet miratimi ... Po patjetër. Jo pothuajse është gati. Po thjesht



të rekordojmë ato të ardhura ato shpenzime që të jetë informacioni të jetë i plotë dhe mos të jetë...

Silvana Aliu . Në momentin që do kemi mbledhjen jashtë radhës që do ta bëjmë për atë që foli...

Rezart Vogli . Ndoshta mund të jetë gati dhe atë mbledhje, patjetër patjetër. Atëherë me shkresën numër 2574 datë 23. 06 .2026 ju informoj domethënë unë ja kam dërguar shkresën e këshillit bashkiak ku ju informoj mbi mosmiratim e tavane të programit zgjedhor afatmesëm 27-29 drejtorja e financave informon se projektimi për miratimin e tavaneve është përgatitur dhe paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit 68/2017 projektvendimi është përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së këshillit bashkiak por deri më sot nuk është miratuar pa u paraqitur një analizë teknike financiare apo ligjore që do evidentojë mangësi në përmbajtjen e tij ose mospërputhje me legjislacionin në fuqi. Mosmiratimi i tavaneve të BBA-së po ndikon drejtpërdrejtë në vijimin normal të procesit të planifikimit financiar dhe buxhetor të bashkisë Rrogozhinë duke krijuar vështirësi në përgatitjen e dokumentave të mëtejshme buxhetore dhe në respektimin e afateve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës. Drejtorja Financës e konsideron se detyrimi i saj për arkëtimin dhe paraqitjen e tavaneve të programit buxhetor afatmesëm është përmbushur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kjo ishte shkresa në lidhje me mosmiratimin e tavaneve përgatitore buxhetore.

Indrit Dedej . Këto problematikat mund të zgjidhni vetë. Po unë do kisha qejf të merrje një vendim kështu një vendim moral si drejtor i financës me që ke pesë, gjashtë muaj që nuk kalon kjo kjo histori... mund të bësh edhe dorëheqje.

Rezart Vogli . Pse arsyeja e thotë ligji? Jo jo unë as nuk të detyroj por edhe marr shkas nga mbledhja e kaluar kur ju zoti ju zoti këshilltar u shprehët që ju nuk jeni as financier as jurist për këtë arsye nuk e miratoni. Faktikisht duhet të jeni ju ai që duhet të jepni dorëheqjen.

Indrit Dedej . Një drejtor që nuk është i aftë të kalojë gjashtë muaj...

Rezart Vogli . Faktikisht duhet ta jepni ju dorheqjen zoti Indrit se mbledhjen e kaluar thatë që s'jeni financier dhe jurist dhe për këtë arsye nuk e miratoni projektvendimin. Detyrimin moral nuk e keni ju se jeni votuar nga qytetarët, kaq ... mos vazhdo mos vazhdo. Mos vazhdo më tutje se je gabim.

Atëherë me shkresën numër 2660/1 datë 29.06.2026 informoj ministrinë e financave dhe prefektin e qarkut ...



Indrit Dedej . Ne po i kërkojmë dorëheqje Ramës jo ty çfarë je ti nuk je asgjë. Zonja kryetare të lutem shumë...

Mukades Gixhari . Mos kalojmë në...

Shpati Kolgega . E keni ulur shumë kërkesën tani nga kryeministri tek drejtori i financës.

Rezart Vogli . Atëherë ministria financës me datë 16.06.2026 dërgon vendimet për programin buxhetor afatmesëm dhe faktikisht deri në datë 16/06/2026 për shkak të mosmiratimit të tavaneve përgatitore buxhetore nuk është bërë asnjë gjë në lidhje me PBA-në 2027-2029. Për këtë arsye unë jam i detyruar si drejtor i Financës t'i dërgoj një kthim përgjigje ku i parashtroj problematikat se për çfarë arsye nuk është bërë asnjë gjë deri në këto momente. Kaq.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Tani jemi tek pika 20 kërkesa për ndihmë financiare z. Veiz Skuqi. Ka bërë një kërkesë për vëllain e tij i cili është me, Rusten Shkuqi i cili jeton i vetëm dhe ka kaluar në një ishemi celebrale, aktualisht është i paaftë për t'u kujdesur për veten, nuk artikulon, nuk ushqehet dhe ka pesë diagnoza.

Fatmira Thartori . Atëherë unë e njoh personalisht zotin Rustem Skuqi meqënëse janë nga Gosa njihemi edhe është në të tillë gjëndje që e përshkruan vëllai i tij. Jemi dakord që të gjithë që ne ta kalojmë këtë, t'i japim një ndihmë, t'i japim një dorë sepse jetoni i vetëm.

Mukades Gixhari . Atëherë do të ja përcjellim drejtorisë përkatëse.

Silvana Aliu . Jo jo ç'lidhje ka drejtoria këtu , drejtoria përkatëse na ka thënë ...

Indrit Dedej . Nuk japim asnjë lek.

Silvana Aliu . E para ... u bë për karrocën të paktën të jeni në dijeni karroca dhe krevati sot e kam çuar, ka shkuar karroca e atij çunit që u dha...

Indrit Dedej . Ne kemi ngërç me drejtorinë e financave dhe drejtorinë sociale.

Silvana Aliu . Si ka mundësi, zonja kryetare po të marrin bashki të tjera që janë njësoj si ne ka shumë ndihma për personat që bëjnë dializë. Japin bëjnë projekt vendime për personat kjo nuk është gjë 500 mijë lekë nuk është gjë ne e japim kur duash po ka dhe persona të tjerë këto që bëjnë dializë persona të tjerë që janë në nevojë 500 mijë lekë nuk është asgjë. Vjen ambulanca



derë e jep shteti, Vjen ambulanca deri në Leka me aq sa jam në dijeni unë vjen ambulanca merr deri në Lekaj, Rrogozhina nuk u përfshi fare, të paktën këto tre persona që janë të Rrogozhinës le t'i marrin. Ikin në mënyrë private.

Hekuran Xhani . O zoti drejtor ka mundësi sepse kjo është e fushës tënde na jap një sqarim si mund ta ndihmojmë këtë qytetarë në nevojë?

Ledian Hasani . Ai qytetar është përfshirë tek ndihma tek fondi i bashkisë është përfshirë e bashkisë është përfshirë ka dy muaj, mund të jetë muaj i tretë. Se për pjesë tjetër pastaj nuk ka bazë ligjore, nuk kam ku mbështetem.

Indrit Dedej . Po pra kjo është problem.

Silvana Aliu . Çfarë bazë ligjore mund të kemi neve që ta miratojmë dhe jetë ...

Ledian Hasani . Nuk e di pastaj tek pjesa e këshillit. Unë flas për drejtorinë që përfaqësoj.

Hekuran Xhani . Tani një pyetje, sqaruese këshilli i drejtohet zyrës së financës dhe thotë pra tani ndihmojë bashkia. Dh thotë duke parë gjendjen e qytetarit është emergjente duam ta ndihmojnë me pesë lekë të vjetra...

Ledian Hasani . Qytetari mund t'i drejtohet edhe komisionit mjekësor mund t'i drejtohet në qoftë se ka kaq ...

Hekuran Xhani . Rezi ne kemi të drejtë që ta ndihmojmë apo jo? Si këshill me 100 mijë lekë të vjetra.

Rezart Vogli . Nga mbledhjet e kaluara ne kemi kaluar projektvendime për ndihmat menjëhershme financiare. Në rastin konkret ta diskutojmë, ta shikojmë kush është baza ligjore dhe...se ju keni kaluar, nuk është se s'keni kaluar.

Hekuran Xhani . Të japim okej si këshill ti të na kthesh përgjigje. Atë e votuam kaloi kjo, o Ver mos na vono më.

Enver Memolla . Në lidhje me këtë është që nëse nuk bëhet nëse përgjigjet për mbledhje jashtë radhe këtë do thoja unë po ka dhe përplasje kompetencash ...dhe këtu e kisha .



Mukades Gixhari . Tek të ndryshme çfarë e kishit tjetër?

Silvana Aliu . Pastrimi i qytetit. Jo, ajo ta dëgjojë dhe të gjithë pastrimi i qytetit sidomos njëherë me dy ndeshjet që kemi pasur... Pastrimi i qytetit është skandal nuk e di se çfarë masash por me pastrimin e qytetit sidomos kur kemi pasur dy ndeshje shumë të rëndësishme që Egnatia edhe rrugët e stadiumit me ... Tani në kontratën që është bërë me firmën është dhe larja domethënë që del makina që... Ka pasur raste që kanë ngelur plehrat dhe dy ditë, tre ditë mes qytetit janë marrë koshat, se ku i kanë çuar koshat nuk e di, ta ketë bashkia koshin përballë derës së vet as atë jo. E para, e dyta parkimi sidomos tani që ka ardhur është ajo që thotë Fatmira që kemi ardhjen e emigrantëve në qendër të qytetit është bërë sikur jeni në mes të Tiranës. Një rrëmujë, policët që turren më shumë ato të rendit që kush mund të fitojë të kapi ndonjë lek se është si puna atij të kapin çfarë të kapim këtë periudhë. Policë bashkiakë nuk shoh fare të kemi një një rregull. Ore i përdorin blloqe këto policët bashkiakë se këtu na sjellin plan masësh, plan masash, ore dalin në terren këto? Kërkojnë rritje rroge çereku po nuk i ke parë ndonjëherë policët bashkiakë.

Pra gjëja më urgjente për mua është njëherë pastrimi i qytetit mirë që gjelbërimi është prishur çdo dyqan tani ka bërë atë ndarjen e vet, kemi pasur një gjelbërim ja kalonim të gjithë qyteteve me trëndafila, një gjelbërim shumë të bukur tani është bërë hajde se e bëri filani rrugën ta bëj dhe unë dal kështu që të merren masat për pastrimin e qytetit. Ashtu si ishte pastruar dikur kur kemi parë ato ullinjtë çfarë ishin ato që kishin krahasitur ullinjtë doli vetë bashkia me i pastruar dhe në raste të ndryshme të paktën kur kemi ndeshje sportive që do vijnë të paktën pastrohet. Kanë ardhur shumë të huaj, tani ta kesh koshin aty as aty nuk e pastroni dot.

Fatmira Thartori . Për sa i përket Njësisë administrative Gosë, së pari do ngrej problemin e dritave, dritat tek ne herë pas here fiken ka raste që rrin me orë, ka raste, ka pasur një rast që ka ndenjur edhe një natë. Së dyti, tek rruga që është për në Vilë, që ikën në bregun e detit, doja pra ne vetëm thjesht po flasim këtu, por të tjerët të dëgjojnë dhe të marrin masa. Tek rruga që ikën për në Vilë, në bregdet, në pjesën ku është Shkumbini dhe po e gërryen Shkumbini, po e gërryen goxha tepër pjesën që është afër xhades, kur sidomos ku është një lokal, nuk ja mbaj mend emrin aty është gërryer jashtë mase dhe po i afrohet po i afrohet rrugës kryesore që ikën për në Spille. Do doja që të merreshin masat për të dyja këto probleme, sidomos për problemin e dritave njëherë që e kanë bërë kështu çdo ditë thuajse sa nga sa çdo ditë çdo ditë nga dy tre herë në ditë, e sidomos ditë mërkure që edhe është edhe të fiken dritat.

Enver Memolla . Unë më shumë e kisha me shërbimet se realisht vetë banorët mbi stacionin e trenit se kështu i themi lagjes tonë unë me Vanën. Ka nga fund i dimrit deri sot nuk është bërë asnjë lloj mirëmbajtje mund të iki dimri kur vjen tjetri është po katastrofë. Është një histori që edhe rrugët janë ngushtuar nuk kam parë asnjë punëtor apo asnjë që një që ka zënë rruga që



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

zotëri po ky në shkelje dhe ligji të vazhdojë vetë.

Altin Tosku . Po u rregullua rruga atje. Po kur erdhi Spiropali, erdhën të gjithë dolën më skrepa punëtorët.

Enver Memolla . Është bërë muaji i tretë nga tre fadroma skrepa që ka bashkia në Rrogozhinë nuk shoh asnjë. nuk e di çfarë po ndodh sidomos me kanalin e madh që bashkia thotë ka bordi, bordi e ka bashkia akoma nuk është pastruar akoma. Pastaj përse i përket pjesës së plehrave merren ato që ngelin digjen

Silvana Aliu . Atëherë kur të vijë Taulant Balla merre bashkë me atë dronin , të shohi gjelbërimin atje dhe ja çoni atij lartmadhërisë çfarë i thoni ju atij mbretit tuaj dhe të thotë mirmëngjes nga Rrogozhina. Mos shini boçet e lulediellit ju e çoni atje lart. Se 1 dynym boçe luledielli e bëtë sikur ishte edhe na kishte marrë malli ta shihnim u bëmë kuriozë dhe shkuam.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër tek të ndryshme?

Indrit Dedej . S'ka flasim kot se nuk na dëgjon njeri.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më pyetje, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 11 : 50⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total : 1 orë 38 min ; 55 sek (i ndarë në 2 video) .
- Ky procesverbal i përmbledhur mbyllet në faqen 35 (tridhjetë e pesë).

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI